



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2315/4 prot.

Datë 05.10.2023

V E N D I M
Nr. 993/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 05.10.2023 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Andi Hamo” P.F. në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-78327-08-25-2023 me objekt “NSHP, Skrep me kovë të parë 1.2m³dhe kovë të pasme 0.5m³”, me fond limit 5,700,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 08.09.2023 nga autoriteti kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Vlorë.

Ankimues: Operatori ekonomik “Andi Hamo” P.F me NIPT K76926201W dhe adresë: Lagjja “Kushtrimi”, Rruga Transballkanike, Banesë private, pranë ish Agjencisë së vjetër, Vlorë.

Autoriteti Kontraktor: Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Vlorë
Lagjja “Kushtrimi”, Rruga “Dervish Hekali”, Vlorë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e

rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 28.08.2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF -78327-08-25-2023, me objekt: “NSHP, Skrep me kovë të parë 1.2m³ dhe kovë të pasme 0.5m³”, me fond limit 5,700,000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 08.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Vlorë.

II.2. Në datë 08.09.2023 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 15.09.2023 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Miri” SHPK	5.300.000	kualifikuar
2. Andi Hamo P.F.	4.890.000	skualifikuar

Operatori ekonomik “Andi Hamo P.F” rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit me arsyetimin se: *“-Operatori ekonomik nuk ploteson Shtojcën 5 të specifikimeve teknike perkatesisht eshte kerkuar pesha e mjetit deri ne 8.1 ton dhe eshte ofruar me e madhe se maksimumi i kerkuar nga Autoriteti Kontraktor duke e paraqitur 9.1 ton. -Eshte kerkuar kova e pasme me kapacitet 0.5m3 dhe nga Operatori Ekonomik eshte ofruar 0.36 m3 dhe si rrjedhoje kjo diference prej 28% ben qe koha dhe shpenzimet per kryerjen e punimeve te jete me e madhe nga sa parashikohet ne buxhetin e Ndermarrjes. -Dokumenti I ngarkuar ne sistem me emrin “TARGETA ORIGJINALE” nuk perputhet me katalogun perkatesisht pesha dhe fuqia”.*

II.4. Në datën 18.09.2023, autoriteti kontraktor ka kryer Publikim Njoftim Fituesi paraprak në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi, ku për këtë procedurë prokurimi është shpallur fituese oferta e operatorit ekonomik “MIRI ” SHPK .

II.5. Në datën 20.09.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2023/3435 dhe me nr. 2315 prot., datë 20.09.2023 e operatorit ekonomik “Andi Hamo” P.F, duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt-ankimi e më konkretisht : ” [...] Vlen per tu permendur se subjekti yne ka pasur eksperienca dhe kontrata te meparshme te ngjashme me kete Autoritet Kontraktor, te cilat jane vleresuar te sukseshme prej tij. Nisur nga eksperienca me kete Autoriteti Kontraktor jemi ne dijeni, qe jo per faj te AK-se po per shkak te dinamikës se punës, egzigjencat dhe kërkesat e ndryshme qe vleresohen ne vijemesi e detyrojne autoritetin qe shpeshhere ne fazen e dorezimit te mjetit te kete kërkesa te shtuara si p.sh. (ndryshim kove, shtim i ndonje pjese ne sherbim te mjetit dhe punes qe do te kryeje etj.) kërkesa qe shpesh nuk shkruhen ne specifikimet teknike ne DST te kerkuara per mjetin.

Sa me sipër, ne menyre qe te realizohet qellimi i prokurimit , i kemi vene ne dispozicion AK-se nje sere zgjedhjesh (kataloget me diversitetin e aksesoreve dhe kovave) te cilat i mundeson prodhuesi i mjetit i cili ne bashkepunojme.

Arsyeja e skualifikimit te AK eshte si me poshte:

Operatori ekonomik nuk ploteson shtojcen nr. 5 te specifikave teknike perkatesisht eshte kerkuar pesha 8.1 dhe kjo peshe eshte ofruar me e madhe se ajo e kerkuar nga AK duke e paraqitur 9.1 ton .

Eshte kerkuar kova e pasme me kapacitet 0.5 m3 dhe nga operatori ekonomik eshte ofruar 0.36 m3.

NSHP, skrep me kove te pare 1.2 m? dhe kove te pasme 0.5m?i REF-78327-08-25-2023

Skicimet, parametrat teknik etj:

Viti: Jo me e vjeter se viti 2012

Pesha deri ne 8.1 ton

Kova e pare me hapje me kapacitet 1-1.3 m3

Kova e pasme me kapacitet 0.5 m3

Fuqia motorike mbi 68 kë

Forca ngritese mbi 64.62KN

Thellesia e germimit 4.5 m

Krahu i pasem me zgjatim

Fenera ndricimi para dhe pas

Pasqyra ne te dyja krahet.

Kundershtimi i vendimit:

Une, Operator Ekonomik e gjykoj të padrejtë vendimin e KVO-së së autoritetit kontraktor, pasi dokumentacioni tekniko-ligjor tek pika 2.3.2 perputhet me (katalogun dhe/ose skedat teknike) i dorëzuar nga operatori ekonomik "Andi Hamo SHPK. (për mjetin "Skrep me kapacitet mbajtës Pesha deri në 8.1 ton",nderkohe O.E ka paraqitur ne skede dhe katalog mjet Skrep te vitit 2015 me peshe 9140 kg= 9.1. AK e ka kerkuar jo me te vjeter se 2012 dhe me peshe 8.1 ton. Theksojme se K.V.O-ja eshte ne kundershtim te hapur me arsyen e skualifikimit sipas nenit 77 të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik, Në nenin 92 të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", Operatori ekonomik provon që kemi të bëjmë me mjet Skrep qe perputhet me specifikat sipas katalogut dhe skedes teknike, që shënohet në regjistra publike sipas shtojces nr 8 te vetdeklarimit, vlerësimi i të cilit bëhet sipas pikës 2.3.2 të kriterëve të veçanta të kualifikimit. Ndërkohë, nga ana e KVO-së, referuar arsyes së skualifikimit, është bërë vlerësim i këtij dokumentacioni sipas shtojces nr 5 dhe jo sipas pikes 2.3.2 të kriterëve të veçanta të kualifikimit. Sa më sipër, me anë të dokumentacionit të dorëzuar në S.P.E. nga operatori ekonomik "ANDI HAMO" SHPK vërtetohet se operatori ekonomik ankimues e përmbush kriterin e përcaktuar në pikën 2.3 te pikes 2.3.2 te kriteret e veçanta të kualifikimit. Theksojme se mjeti qe ne do te ofrojme prane AK perputhet me cfare eshte kerkuar dhe do te jete ne funksion per pastrimin e kanaleve ujtese dhe kulluese apo puneve publike qe do te perdore AK. Theksojme se ne si operator ekonomik kemi 12 vjet qe ushtorjme pune te realizuar me suksese ndaj kesaj ndermarrje duke vete mireargumentuara dhe duke i pare tek regjistri online i regjistrit te buletinit, qofte per Blerje mjetesh, qofte edhe per shitje te tyre pasi jemi te licencuar ne treg per Autoriteti Kontartkor ka vepruar ne kundershtim me ligjin e prokurimeve duke bere shpalljen e njoftim fituesit ne orar jo zyrtar ne daten 15.09.2023 ora 20.46 dhe njoftim i fituesit ne SPE per ofertuesin MIRI rezulton

te jete po ne ate date por ne oren jashte orarit zyrtar nga ana e personit pergjegjes per prokurimit publik. Autoriteti Kontraktor ka bere nje dem ekonomik me nje diference prej 410,000 leke pa TVSH Argumentime mbi shkeljet e pretenduara. Ne permbdhje te ankesese kerkojme: Rivlersimin e procedures nga ana e KVO-se duke na shpallur ne baze te ofertes ekonomike operatorin e renditur te pare si te kualifikuar. Ne kete menyre do te shmangeshin vonesat ne levrimin e mallit si dhe demi ekonomik i cili do t'i krijohet Institucionit dhe buxhetit te BASHKISE VLORE..

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. prot 2315/2 date 21.09.2023, lidhur me arsyet e skualifikimit te operatorit ekonomik ankimes.

II.7. Autoriteti kontraktor ka dërguar nëpërmjet sistemit shkresën nr. Prot., datë 29.09.2023 me objekt: “Vendim ne lidhje me ankesën e operatorit ekonomik..”, protokolluar me tonën me nr.2315 datë 02.10.2023, sipas së cilës rezulton, se autoriteti kontraktor ka refuzuar ankesën e operatorit ekonomik me argumentin se: “ [...] Në zbatim të urdhrit të mësipërm pasi u njohëm me pretendimet e Operatorit Ekonomik nëpërmjet ankesës së depozituar prej tyre, ne si KSHA pas shqyrtimit të gjithë dokumentacionit të administruar në dosjen e tenderit për këtë procedurë, kriterëve të veçanta të kualifikimit sipas dokumentacionit përkatës dhe specifikimeve teknike, po ju paraqesim konstatimet e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave:

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

“-Operatori ekonomik nuk plotëson Shtojcën 5 të specifikimeve teknike përkatësisht është kërkuar pesha e mjetit deri në 8.1 ton dhe është ofruar më e madhe se maksimumi I kërkuar nga Autoriteti Kontraktor, duke e paraqitur 9.1 ton. -Është kërkuar kova e pasme me kapacitet 0.5m3 dhe nga Operatori Ekonomik është ofruar 0.36 m3 dhe si rrjedhojë kjo diferencë prej 28% bën që koha dhe shpenzimet për kryerjen e punimeve të jetë me e madhe nga sa parashikohet në buxhetin e Ndërmarrjes. -Dokumenti i ngarkuar në sistem me emrin “TARGETA ORIGJINALE” nuk përputhet me katalogun përkatësisht pesha dhe fuqia.”.

Për sa më sipër pretendimi i Operatorit Ekonomik nuk pranohet për arsye:

Referuar argumenteve dhe bazës ligjore Autoriteti kontraktor është treguar i qartë, në përputhje me ligjin (LPP) 162/2020, dhe Rregullave të Prokurimit Publik, VKM 285, dt.19.5.2023, për kriteret e kërkuara në specifikimet teknike të shtojcës 5, Dokumentet Standarde te Tenderit. Operatori ekonomik, “ANDI HAMO PF” nuk plotëson kushtet e Nenit 36, të Ligj Nr. 162/2020, Për Prokurimin Publik, ku specifikimet teknike përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit dhe entit kontraktor. Sa më sipër sqarojmë se pretendimet e operatorit ekonomik se specifikimet teknike nuk ishin të qarta nuk qëndrojnë pasi, gjatë afatit të njoftimit të kontratës në platformën elektronike në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 162 datë 23.12.2020 ‘Për Prokurimin Publik’ (neni 75), ku cdo operator ekonomik nëse kërkon sqarime mund t’ i drejtohet autoritetit përkatës

në rrugë elektronike, në mënyrë që dhe sqarimi nga ana e AK të jetë publik për të gjithë të interesuarit, Konstatohet se gjatë afatit të njoftimit të kontratës në platformën elektronike nuk është paraqitur asnjë kërkesë nga operatorët ekonomikë

Skicimet, parametrat teknik etj:

Viti: Jo më e vjetër se viti 2012

Pesha deri në 8.1 ton

Kova e parë me hapje me kapacitet 1-1.3 m³

Kova e pasme me kapacitet 0.5 m³

Fuqia motorike mbi 68 kë

Forca ngritëse mbi 64.62KN

Thellësia e gërmimit 4.5 m

Krahu i pasëm me zgjatim

Fenera ndriçimi para dhe pas

Pasqyra në të dyja krahët.

... Operatori ekonomik pretendon se:

Theksojme se ne si operator ekonomik kemi 12 vjet qe ushtrojme pune te realizuar me suksese ndaj kesaj ndermarrje duke i vetemireargumentuar dhe duke i pare tek regjistri online i regjistrimit te buletinit, qofte per Blerje mjetesh, qofte edhe per shitje te tyre pasi jemi te licencuar ne treg por Autoriteti Kontartkor ka vepruar ne kundershtrim me ligjin e prokurimeve duke bere shpalljen e njoftim fituesit ne orar jo zyrtar ne daten 15.09.2023 ora 20.46 dhe njoftim i fituesit ne SPE per ofertuesin MIRI rezulton te jete po ne ate date por ne oren jashte orarit zyrtar nga ana e personit pergjegjes per prokurimit publik

Sqarojmë se:

Autoriteti Kontraktor i përmbahet përcaktimeve të nenit 2 dhe3 të LPP,

a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik

b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;

c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;

dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik për të garantuar trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë dhe për të mos ngushtuar konkurrencën,

si rrjedhojë AK nuk vlerëson në bazë të viteve të punës, po në bazë të një dokumentacioni të rregullt të ofruar duke plotësuar kriteret e kërkuara. Për sa i përket orarit zyrtar, nuk janë OE të cilët vlerësojnë efikasitetin e punës por organet më të larta kompetente.

Pretendimet e OE nuk pranohen! “

II.8. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e autoritetit kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime

nga subjekte të tjera të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur kësaj ankese,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Andi Hamo” P.F, mbi skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt - shqyrtimi me arsyen se: “*Operatori ekonomik nuk ploteson Shtojcën 5 të specifikimeve teknike perkatesisht eshte kerkuar pesha e mjetit deri ne 8.1 ton dhe eshte ofruar me e madhe se maksimumi i kerkuar nga Autoriteti Kontraktor duke e paraqitur 9.1 ton. -Eshte kerkuar kova e pasme me kapacitet 0.5m3 dhe nga Operatori Ekonomik eshte ofruar 0.36 m3 dhe si rrjedhoje kjo diference prej 28% ben qe koha dhe shpenzimet per kryerjen e punimeve te jete me e madhe nga sa parashikohet ne buxhetin e Ndermarrjes. -Dokumenti I ngarkuar ne sistem me emrin “TARGETA ORIGJINALE” nuk perputhet me katalogun perkatesisht pesha dhe fuqia*”. “,
Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 5 të dokumenteve standarde të tenderit autoriteti kontraktor ka kërkuar:
Shtojca 5.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për

të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Viti: Jo më e vjetër se viti 2012

Pesha deri në 8.1 ton

Kova e parë me hapje me kapacitet 1-1.3 m³

Kova e pasme me kapacitet 0.5 m³

Fuqia motorike mbi 68 kw

Forca ngritëse mbi 64.62KN

Thellësia e gërmimit 4.5 m

Krahu i pasëm me zgjatim

Fenera ndriçimi para dhe pas

Pasqyra në të dyja krahët.

Përshkrimi I kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

III.1.2. Në dokumentet e tenderit, shtojca 7/2, “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.2., “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të tenderit, të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë për mallin objekt prokurimi, katalogun dhe/ose skedat teknike, që nën kupton se duhet të jenë me logon e tij dhe ku jepen të gjitha karakteristikat teknike të këtyre materialeve me përkthim të licencuar me qëllim që autoriteti kontraktor të verifikojë përmbushjen e specifikimeve teknike.

III.1.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik, si dhe informacionit të dhënë nga autoriteti kontraktor, operatori ekonomik “Andi Hamo”P.F., në përmbushje të kriterit të mësipërm, ka paraqitur në SPE dokumentacionin si më poshtë:

- Dokumentin e emërtuar “Skeda teknike me përkthim të licencuar”
- Dokumentin e emërtuar “Targeta origjinale”

III.1.4. Referuar Nenit 2 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se: *Qëllim i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.1.5. Referuar Nenit 3, “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i cili parashikon shprehimisht se:

- 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

III.1.6. Në nenin 36 “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. *Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.*

3. *Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:*

a) *kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;*

b) *standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;*

c) *kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;*

ç) *të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".*

4. *Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".*

5. *Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "b" të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.*

6. *Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "a" të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet*

ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifitime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

III.1.7. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme

njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

Ndërsa në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.”.

III.1.8. Në nenin 40, “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 2, 3 e 5 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet: “2.Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara. 3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve...”

5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*
- c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.*

III.1.9. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.10. III.1.10. Nga shqyrtimi dhe verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se, operatori ekonomik ankimues në përmbushje të kriterit për disponimin e mallit objekt prokurimi, Skrep me kovë të parë 1.2 m³ dhe kovë të pasme 0.5m³, sipas përcaktimeve të bëra në specifikimet teknike pjesë e dokumentave standarte të tenderit, ka paraqitur keto dokumenta: “*Skeda teknike me përktim të liçencuar*” dhe “*Targeta origjinale*”. Nga verifikimi i tyre rezulton se operatori ekonomik ankimues “Andi Hamo” P.F., ka paraqitur katalogun me specifikime teknike për më shumë se një makineri dhe Skedën teknike. Në dokumentat standarte të tenderit autoriteti kontraktor ka përcaktuar në mënyrë të qartë kriterin e kualifikimit “*2.3.2 dhe specifikimet teknike të mallit objekt prokurimi në shtojcën 5*”, duke mos lënë mundësinë e paraqitjes së opsioneve apo varianteve për përmbushjen e kriterëve dhe specifikimeve teknike të mallit objekt prokurimi. Referuar parashtrimeve në ankesë të operatorit ekonomik ankimues “Andi Hamo” P.F ku pretendon se: “[...] Vlen per tu permendur se subjekti yne ka pasur eksperiencia dhe kontrata te mepareshme te ngjashme me kete Autoritet Kontraktor, te cilat jane vleresuar te suksesshme prej tij. Nisur nga eksperiencia me kete Autoritet Kontraktor jemi ne djeni qe, jo per faj te AK-se po per shkak te dinamikës se punës, egzigjencat dhe kerkesat e ndryshme qe vleresohen ne vijemesi e detyrojne autoritetin qe shpeshhere ne fazen e dorezimit te mjetit te kete kerkesa te shtuara si p.sh. (ndryshim kove, shtim i ndonje pjese ne sherbim te mjetit dhe punes qe do te kryeje etj.) kerkesa qe shpesh nuk shkruhen ne specifikimet teknike ne DST te kerkuara per mjetin. Sa me

siper, ne menyre qe te realizohet qellimi i prokurimit , i kemi vene ne dispozicion AK-se nje sere zgjedhjesh (kataloget me diversitetin e aksesoreve dhe kovave) te cilat i mundeson prodhuesi i mjetit me të cilin ne bashkepunojme.[...]”, KPP konstaton se ankimuesi pranon që nuk disponon makinerinë objekt prokurimi (Skrep me kovë të parë 1.2m³ dhe kovë të pasme 0.5m³) sipas specifikimeve teknike që ka parashikuar autoriteti kontraktor në shtojcën 5 të dokumentave standarte të tenderit, me pretendimin se *kerkesat e autoritetit kontraktor shpeshhere ne fazen e dorezimit te mjetit ndryshojnë, shtohen, arsye për të cilën ai ka paraqitur disa variante katalogësh për mallin objekt prokurimi*. Nga sa më sipër dokumentacioni i paraqitur nga ana e operatorit ekonomik ankimues (katalogu për më shumë se një makineri) nuk është në përputhje me kriterin e vecantë të kualifikimit 2.3.2 dhe specifikimet teknike të shtojcës 5.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se përmbushja e kriterëve të veçanta të kualifikimit apo edhe specifikimeve teknike duhet të përmbushen nga të gjithë operatorët ekonomikë pjesmarrës në procedurë për realizimin me sukses të kontratës. Komisioni gjykon se përmbushja e kriterëve ekonomike, teknike, profesionale është një detyrim që buron nga ligji i cili në mënyrë taksative kërkon përmbushjen e tyre nga të gjithë operatorët ekonomik pjesmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri apo specifikimi të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor në dokumentat standarte të tenderit në shërbim të realizimit të kontratës e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin elektronik te prokurimeve nga operatori ekonomik “Andi Hamo” P.F., “*Skeda teknike me përkthim të liçencuar*” dhe “*Targeta origjinale*”, K.P.P, gjykon se nga operatori ekonomik nuk janë plotësuar të gjitha kriteret e kërkuara nga autoriteti kontraktor ne dokumentat e tenderit, e më konkretisht nuk vërtetohet disponueshmëria e makinerisë objekt prokurimi (Skrepit me kovë të parë 1.2m³ dhe kovë të pasme 0.5m³) sipas përcaktimeve të bëra nga autoriteti kontraktor në shtojcën 5 të dokumentave standarte të tenderit. KPP gjykon se i takon operatorëve ekonomikë të provojnë se disponojnë kapacitetet e kërkuara në përputhje me kriteret kualifikuese. Në rastin konkret Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se, ankimuesi nuk ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar nga autoriteti kontraktor sipas përcaktimeve të bëra në dokumentat standarte të tenderit.

III.1.11. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri apo specifikimi të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor në dokumentet standarde të tenderit e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme. Operatori ekonomik duhej të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve. Operatori ekonomik është i detyruar të përgatisë ofertën, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion. Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Andi Hamo” P.F në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk konsiderohet i vlefshëm.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Andi Hamo” P.F nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Andi Hamo” P.F, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-78327-08-25-2023 me objekt “NSHP, Skrep me kovë të parë 1.2m³ dhe kovë të pasme 0.5m³”, me fond limit 5,700,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 08.09.2023 nga autoriteti kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Vlorë.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Andi Hamo” P.F, SHPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri